



Pikiata e Universiteteve Publike

RAPORT MONITORIMI

Gusht-Tetor 2022

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al



AUTOR
GEVIO TABAKU

Regjistrimet në Universitete

Në vendin tonë gjenden gjithsej **40** institucione të arsimit të lartë, ku nga këto **13** janë institucione publike dhe **27** janë institucione private. Këto institucione janë shtëpi e mbi **555** programesh studimi nga ku burojnë mbi **32 007** kuota tek të cilat mund të regjistrohen të gjithë kandidatët e interesuar.

	Procesi	Kohëzgjatja	Periodha
RAUNDI 1	Aplikimi - Pagesë tarife	26 ditë	05.07.2022 - 28.07.2022
	Aplikimi Online - Përzgjedhja e 10 programeve të studimit	6 ditë	29.07.2022 - 03.08.2022
	Publikimi i renditjes së aplikantëve në U-Albania	1 ditë	31.08.2022
	Ankimimi	1 ditë	01.09.2022
	Regjistrimi në IAL / Publikimi ne kohe reale i renditjes (7 faza 48-orëshe)	14 ditë	02.09.2022 - 15.09.2022
	Çregjistrimi (Raundi 1) / regjistrim i fituesve pas ankimimit	2 ditë	16.09.2022 - 17.09.2022
RAUNDI 2	Aplikimi - Pagesë tarife	16 ditë	02.09.2022 - 16.09.2022
	Aplikimi Online - Përzgjedhja e 10 programeve të studimit	3 ditë	22.09.2022 - 24.09.2022
	Publikimi i renditjes së aplikantëve në U-Albania	1 ditë	30.09.2022
	Ankimimi	1 ditë	01.10.2022
	Regjistrimi në IAL/ Publikimi ne kohe reale i renditjes (5 faza 48-orëshe)	10 ditë	03.10.2022 - 12.10.2022
	Çregjistrimi (Raundi 2) / regjistrim i fituesve pas ankimimit	2 ditë	13.10.2022 - 14.10.2022
RAUNDI 3	Aplikimi - Pagesë tarife	15 ditë	01.10.2022 - 15.10.2022
	Aplikimi Online - Përzgjedhja e 10 programeve të studimit	3 ditë	19.10.2022 - 21.10.2022
	Publikimi i renditjes së aplikantëve në U-Albania	1 ditë	26.10.2022
	Regjistrimi në IAL/ Publikimi ne kohe reale i renditjes (3 faza 48-orëshe)	6 ditë	28.10.2022 - 02.11.2022
	Kërkesë dhe Regjistrimi në sekretariatë mësimore të njësisve kryesore (fakultet), në programet e studimit në të cilat nuk kanë fituar në raundin e tretë	4 ditë	03.11.2022 - 06.11.2022
	Kërkesë dhe Regjistrimi pranë IAL-ve, pavarësisht aplikimeve në tre raundet në portalin U-Albania	2 ditë	07.11.2022 - 08.11.2022

Mundësinë për t'u regjistruar në universitet e gëzojnë maturantët që kanë plotësuar formularin A1 dhe që rezultojnë kalues në provimet e maturës, si edhe gjithë kandidatët e tjerë të cilët nuk janë regjistruar më përpara në një IAL publike ose private. Këta kandidatë duhet të plotësojnë formularin A1Z dhe të jenë gjithashtu kalues në provimet e maturës.

Procesi i regjistrimit në universitet kalon në tre raunde aplikimi, të cilët janë të pavarur nga njëri-tjetri. Më poshtë paraqitet kalendari i aplikimit universitar, bashkë me të gjithë proceset, për vitin 2022.

Gjatë viteve të fundit procedurat kanë ndryshuar disa herë. Edhe këtë vit proceset e aplikimit kanë pësuar risi dhe ndryshime. Për kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në IAL këto ndryshime të vazhdueshme nuk janë të qëndrueshme dhe në shumë raste e komplikojnë akoma më tepër procesin e aplikimit. Një shtesë e re që është realizuar gjatë këtij viti, duke iu referuar urdhrin nr.8, datë 30/06/2022¹, është edhe shtimi i "raundit të katërt", duke bërë të mundur që të regjistrohen në një IAL publike ose private edhe kandidatë të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi gjatë tre rraundeve të mëparshme, por që janë pjesë e portalit UAlbania. Kushti i vetëm që këta kandidatë të mund të regjistrohen në një program studimi i cili ka kuota të lira edhe pas përfundimit të rraundeve të aplikimit, është plotësimi i mëparshëm i formularit A2/A3.

¹ https://ualbania.al/theme/files/urdher_rash_qsha_nr.8_2022.pdf



Rënia e numrit të studentëve ndër vite në universitetet publike

Vit pas viti vihet re një ulje e numrit të studentëve dhe nxënësve, dhe shkak kryesor për këtë gjë është emigracioni masiv i familjeve shqiptare kryesisht drejt vendeve të BE-së². Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Arsimit, në vitin shkollor 2022-2023 janë regjistruar në klasën e 10 rreth 28 mijë nxënës, gati 10% më pak në krahasim me vitin shkollor 2021-2022 (31 mijë nxënës)³.

Kjo rënie ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe universitetet, të cilat mirëpresin çdo vit e më pak studentë në auditorët e tyre. Në vitin akademik 2018-2019, numëroheshin 64.544 studentë në universitetet publike, ky numër shkoi në 60.922 gjatë vitit akademik 2019-2020 dhe 58.016 në vitin akademik 2020-2021 (INSTAT)⁴. Duke marrë në analizë të dhënat e mësipërme, përlogaritet që universitetet publike humbasin 3-mijë studentë në vit. Përsëritja e këtyre të dhënave na jep projeksionin se në vitin 2030, Shqipëria do të ketë 41% më pak studentë nga sa ka sot, pra vetëm 34 mijë studentë (në universitetet publike).

Kontribut në këtë rënie drastike të numrit të studentëve është edhe kriteri i vendosur mbi mesataren minimale. Deri në vitin akademik 2018-2019, kushdo kandidat që gëzonte mesatare më të lartë se 6.0 mund të konkuronte për të fituar të drejtën e studimit në universitet. Me ndryshimet e bëra gjatë fillimit të vitit akademik 2019-2020, kriteri i mesatares u ndryshua në 6.5⁵.

Ndryshimet ishin edhe më rrënjësore për ata kandidatë që dëshironin të studionin në një program studimi i cili jep akses në programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë, ku kriteri i mesatares është 7.5. Ministria e Arsimit erdhi fillimisht me planin për të rritur më tej kriterin e notës mesatare në 8 për këta kandidatë⁶ - duke filluar nga viti akademik 2022-2023 - por e anuloi këtë vendim pasi do sillte rënie të mëtejshme të numrit të regjistrimeve dhe mbylljen e një pjese të madhë të këtyre programeve të studimit.

Problematika tjetër me këtë vendimmarrje është se dikush që ka pasion historinë nuk dëshiron domosdoshmërisht të marrë profesionin e mësuesit. E njëjta logjikë edhe me pjesën më të madhe të këtyre programeve të studimit. U deshën plotë katër vite⁷ dhe me mijëra kandidatë të penalizuar që Ministria

²<https://www.monitor.al/emigracioni-po-zbraz-vendin-instat-zbulon-se-ka-7-1-mije-familje-me-pak-se-ne-2018-n/>

³<https://www.portalishkollor.al/news/sot-nisi-viti-i-ri-shkollor-2022-2023-ne-gjimnaze-shenohet-numri-me-i-ulet-i-regjistrimeve-te-nxenesve>


⁴ Të dhënat e vitit akademik 2022-2023 nuk janë publikuar ende në kohën e përpilimit të këtij raporti.

⁵ <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2018/05/21/18>

⁶ <https://fdut.edu.al/wp-content/uploads/2021/09/Vendimi-I-KM-Nr.-436-dat%C3%AB-03062020.pdf>

⁷ Kriteri i mesatares për degët e mësuesisë është vendosur fillimisht në vitin 2018 dhe kjo mesatare ishte 7. VKM Nr. 216, datë 20.4.2018, <https://ualbania.al/theme/files/VKM%20nr.%20216,%20date%2020.4.2018.pdf>

e Arsimit të ndryshonte qasje dhe t'i lejonte këta kandidatë të regjistroheshin, duke vendosur kriterin e mesatares vetëm për të filluar studimet në programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë⁸.



Një trend që vihet re gjatë krahasimit të regjistrimeve në IAL publike dhe private nga viti akademik 2018-2019 deri në vitin akademik 2021-2022, është dëshira gjithnjë e në rritje e kandidatëve për t'u regjistruar në IAL-të private. Në vitin akademik 2018-2019, 17 536 studentë zgjodhën të studionin në një IAL publike, ndërsa 4 753 studentë në ato private. Statistikat e fundit (viti akademik 2021-2022) na tregojnë se numri i të regjistruarve në IAL-të publike është tkurrur me 11.3%, ndërsa numri i të regjistruarve në IAL-të private është rritur me 14% (në krahasim me vitin akademik 2018-2019).

Arsyet që kanë ndikuar në shtimin e interesit të studentëve për t'u regjistruar në IAL-të private janë të shumta. Ndër to mund të veçojmë reagimin e dobët që IAL-të publike patën gjatë krizës së pandemisë Covid-19, ku ardhja me një plan të shpejtë dhe efikas për kalimin e mësimit nga auditori në online solli kosto të shtuar për studentët. Një aspekt tjetër që lidhet me dëshirën e studentëve për t'u arsimuar në IAL-të private janë edhe kushtet infrastrukturore që ato ofrojnë, në kontrast me kushtet e IAL-ve publike, të cilat janë kritikuar vazhdimisht nga studentët. IAL-të publike nuk shpenzojnë para për reklamimin dhe marketingun e programeve të tyre të studimit dhe vlerës që mbart diploma e tyre, kundrejt fushatave intensive të IAL-ve private, gjatë periudhës së regjistrimeve të kandidatëve.

⁸ <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2022/06/22/15/0572ea08-c9a4-4b99-b903-05de4b029726>

Fati i programeve prioritare

Në muajin qershor të këtij viti Ministria e Arsimit erdhi me një vendim të ri⁹, për t'i dhënë çdo studenti të shkëlqyer ose që zgjedhë të studiojë në një nga programet prioritare mundësinë e përfitimit të një burse mujore, e cila është e barazvlefshme me pagën minimale (34 000 lekë, nëntor 2022). Përveç shpërblimit mujor, kjo bursë i heq studentëve përfitues edhe detyrimin për të paguar tarifën vjetore.

Politikat e ndërmarra nga Këshilli i Ministrave ndër vite në lidhje me ndryshimin e kriterit të notës mesatare rezultuan në braktisjen e këtyre programeve. Për të minimizuar efektin e kësaj vendimmarrjeje politike, qeveria dhe MAS prezantuan një formë të re incentive për këto programe, e cila është mbështetja me pagesë, në mënyrë që të riparohen dëmet e krijuara nga vendimmarrjet e kaluara.

Përfitues të kësaj burse, janë të gjithë studentët që:

1. Nuk janë përfitues të ndonjë financimi tjetër nga shteti shqiptar.
2. Plotësojnë një nga kriteret e mëposhtme:
 - a. Kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00 dhe në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.5 deri në 10.00;
 - b. Studenti fitues i njërit prej tri çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare të arsimit parauniversitar, me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse, pavarësisht notës mesatare, kur pranohet në programe studimi, që lidhen me lëndën/t/disiplinën ku ka fituar çmimin;
 - c. Studenti, i cili ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar dhe që ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare, jo më pak se 8.5, përfshirë notën e përshkallëzuar të provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore;

Bursa vjen në një kohë ku studentët gjithnjë e më shumë po orientohen drejt regjistrimit në programe studimi me fokus teknologjinë dhe shkencat mjekësore teknike, si një mënyrë e shpejtë për t'u larguar nga vendi. Kjo bursë synon që të parandalojë pikërisht këtë largim. Sipas VKM Nr. 386, datë 1.6.2022, studentët të cilët kualifikohen në një nga pikat e mësipërme duhet të firmosin një kontratë me shtetin shqiptar, e cila i detyron ata të punojnë për tre vite pas diplomimit të tyre në administratën publike.

⁹ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/06/01/386/2b481639-f529-4d28-be00-217d991371b6>

Pjesë e kësaj burse nuk janë vetëm studentët e shkëlqyer, por edhe ata studentë të cilët gëzojnë mesatare mbi 8.5 dhe që regjistrohen në një nga programet që përbëjnë prioritet kombëtar. Këto programe ndahen në disa fusha studimi, të tilla si:

- Arte dhe humanitet
- Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë
- Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim
- Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinar
- Shërbime

Janë gjithsej 35 programe studimi të cilat konsiderohen prioritet kombëtar dhe që bëjnë studentët e kategorive të mësipërme përfitues të kësaj burse. Natyrisht, nëse një student që plotëson kriteret e mësipërme nuk dëshiron të jëtë përfitues i bursës, ai/ajo mund ta refuzojë atë. Problematik mbetet fakti që Ministria e Arsimit nuk ka kryer asnjë studim tregu (ose edhe nëse e ka kryer nuk e ka publikuar për publikun e gjërë) në lidhje me kriteret se përse këto programe studimi janë përzgjedhur si prioritare.

Më poshtë kemi paraqitur tabelën me të gjitha programet e studimit që konsiderohen prioritet kombëtar.

Fushat e Studimit	Programi i Studimit
Arte dhe humanitet	Gjuhë shqipe dhe letërsi
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	Biologji
	Biologji-kimi
	Studime mjedisore
	Shkenca mjedisore
	Kimi
	Fizikë
	Matematikë
	Matematikë-fizikë
Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	Inxhinieri mjedisi
	Inxhinieri navale
	Navigacion dhe menaxhim detar
	Inxhinieri e burimeve minerare
	Inxhinieri e naftës dhe gazit



	Inxhinieri gjeoinformatike
	Inxhinieri gjeologjike
	Inxhinieri gjeomjedis
Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinari	Inxhinieri agrare profil mbrojtje bimësh
	Inxhinieri agrare profil hortikulture
	Inxhinieri agrare profil agronomi
	Inxhinieri agrare profil agromekanizëm
	Zootekni dhe siguria e produkteve blegtorale
	Biologji marine dhe akuakulturë
	Bioteknologji zooveterinare
	Agrobiologji
	Agrobiznes
	Agroushqim
	Vreshtari enologji
	Inxhinieri agronomike
	Inxhinieri pyjore
	Inxhinieri përpunim druri
	Mjekësi veterinare
Shërbime	Menaxhim turizmi (rural, arkeologjik, kulturor, hotelieri- restorant, mikpritje)
	Ekonomi-turizëm
	Turizëm

Analiza e programeve prioritare sipas universiteteve¹⁰

Universiteti	Programe Studimit që konsiderohen prioritare	Porgrame studimi që rrezikojnë të mbylljen	Programe studimi që janë mbyllur
Universiteti i Tiranës	6	3 (50%)	-
Universiteti Politeknik i Tiranës	6	3 (50%)	-
Universiteti Bujqësor i Tiranës	17	7 (41%)	4 (23.5%)
Universiteti i Durrësit	3	2 (66%)	-
Universiteti i Elbasanit	4	4 (100%)	-
Universiteti i Vlorës	6	6 (100%)	-
Universiteti i Korçës	4	4 (100%)	-
Universiteti i Shkodrës	4	2 (50%)	-
Universiteti i Gjirokastrës	3	3 (100%)	-
Totali	53	38 (71.6%)	

Universiteti i Tiranës

Fushat e Studimit	Programi i Studimit	Kuota të vlefshme	Studentë të regjistruar
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	Shkenca mjedisore	40	3
	Kimi	100	9
	Fizikë	90	6
	Matematikë	90	21
	Biologji	100	44
Arte dhe humanitet	Gjuhë shqipe dhe letërsi	165	73

¹⁰ Të dhënat janë marrë nga portali i aplikimit universitar, UAlbania (<https://ualbania.al/>), gjatë muajit nëntor 2022.

Universiteti Politeknik i Tiranës

Fushat e Studimit	Programi i Studimit	Kuota të vlefshme	Studentë të regjistruar
Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	Inxhinieri e burimeve minerare	50	7
	Inxhinieri gjeologjike	50	9
	Inxhinieri gjeomjedis	50	5
	Inxhinieri mjedisi	60	27
	Inxhinieri e naftës dhe gazit	50	16
	Inxhinieri gjeoinformatike	50	18

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Fushat e Studimit	Programi i Studimit	Kuota të vlefshme	Studentë të regjistruar
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	Shkenca mjedisore	70	5
Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinari	Inxhinieri agrare profil agromekanizëm	-	-
	Biologji marine dhe akuakulturë	-	-
	Bioteknologji zooveterinare	-	-
	Vreshtari enologji	-	-
	Inxhinieri agrare profil mbrojtje bimësh	50	8
	Inxhinieri agrare profil hortikulture	30	2
	Inxhinieri agrare profil agronomi	50	5
	Zootekni dhe siguria e produkteve blegtorale	30	2
	Agrobiologji	30	1
	Inxhinieri agronomike	50	5

	Agrobiznes	120	78
	Agroushqim	153	62
	Inxhinieri pyjore	32	13
	Inxhinieri përpunim druri	55	28
	Mjekësi veterinare	100	72
Shërbime	Menaxhim turizmi (rural, arkeologjik, kulturor, hoteleri-restorant, mikpritje)	90	32

Universiteti i Durrësit

Fushat e Studimit	Programi i Studimit	Kuota të vlefshme	Studentë të regjistruar
Shërbime	Menaxhim turizmi (rural, arkeologjik, kulturor, hoteleri-restorant, mikpritje)	25	3
	Turizëm	40	1
Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	Navigacion dhe menaxhim detar	30	14

Universiteti i Elbasanit

Fushat e Studimit	Programi i Studimit	Kuota të vlefshme	Studentë të regjistruar
Arte dhe humanitet	Gjuhë shqipe dhe letërsi	25	2
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	Biologji-kimi	30	1
	Studime mjedisore	35	2
Shërbime	Ekonomi-turizëm	50	6

Universiteti i Vlorës

Fushat e Studimit	Programi i Studimit	Kuota të vlefshme	Studentë të regjistruar
Arte dhe humanitet	Gjuhë shqipe dhe letërsi	45	7
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	Biologji	35	9
	Matematikë	27	3
	Matematikë-fizikë	20	3
Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	Inxhinieri navale	30	7
Shërbime	Menaxhim turizmi (rural, arkeologjik, kulturor, hoteleri-restorant, mikpritje)	30	9

Universiteti i Korçës

Fushat e Studimit	Programi i Studimit	Kuota të vlefshme	Studentë të regjistruar
Arte dhe humanitet	Gjuhë shqipe dhe letërsi	25	3
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	Biologji-kimi	30	6
Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinar	Inxhinieri agronomike	50	3
Shërbime	Menaxhim turizmi (rural, arkeologjik, kulturor, hoteleri-restorant, mikpritje)	40	3

Universiteti i Shkodrës

Fushat e Studimit	Programi i Studimit	Kuota të vlefshme	Studentë të regjistruar
Arte dhe humanitet	Gjuhë shqipe dhe letërsi	40	8
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	Matematikë	40	4
	Biologji-kimi	55	15
Shërbime	Turizëm	100	39

Universiteti i Gjirokastrës

Fushat e Studimit	Programi i Studimit	Kuota të vlefshme	Studentë të regjistruar
Arte dhe humanitet	Gjuhë shqipe dhe letërsi	20	1
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	Biologji-kimi	15	3
Shërbime	Turizëm	15	1

Nga analiza e kryer rezulton se bursa nuk ka patur efekt tek studentët dhe se ata nuk kanë zgjedhur të studiojnë në programet prioritare. Rreth 71.6% e këtyre programeve rrezikojnë të mbyllen si pasojë e mos plotësimit të numrit minimal prej jo më pak se 10 studentë të regjistruar, ndërsa katër nga këto programe studimi janë mbyllur që pa nisur mirë implementimi i programit të bursave, sinjal tepër i qartë për vendimmarrësit në lidhje me suksesin e kësaj iniciative.

Dështimi i bursave për studentët në programet prioritare lidhet thellë me dëshirën e studentëve për t'u regjistruar në degët e studimit që shërbejnë si "pasaportë" për të ikur jashtë vendit. Sipas analizës tonë, e cila ka marrë në konsideratë programin e studimit Infermieri në të gjitha universitetet publike të vendit, rezulton se nga studentët janë ezauruar mbi 92% e kuotave të vlefshme, ndërsa në programet prioritare janë ezauruar vetëm 27% e këtyre kuotave.

Gjetjet kryesore

- Raundi i katërt i aplikimeve universitare cënon sistemin meritë-preferencë duke minuar procesin dhe parimet e garës së drejtë.
- Universitetet publike humbasin gati 3 000 studentë në vit. Brenda vitit 2030 në universitetet publike do të studiojnë 41% më pak studentë.
- Numri i të regjistruarve në IAL-të publike është tkurrur me 11.3%, ndërsa numri i të regjistruarve në IAL-të private është rritur me 14%¹¹.
- Studentët vijojnë të orientohen drejt programeve të studimit që shërbejnë si “pasaportë” për të emigruar. Në programin e studimit Infermieri janë ezauruar 92% e kuotave të vlefshme (në universitetet publike).
- 71.6% e programeve prioritare të studimit rrezikojnë të mbyllen si pasojë e mos plotësimit të numrit minimal prej jo më pak se 10 studentë të regjistruar ndërkohë që 4 programe janë mbyllur fill pas prezantimit të iniciativës. Në këto programe studimi janë plotësuar vetëm 27% e kuotave totale¹².
- Përcaktimi i programeve prioritare nuk ka ardhur si rrjedhojë e një studimi të tregut të punës dhe prioriteteve ekonomike dhe strategjike të vendit.

Rekomandime

- Ministria e Arsimit duhet të implementojë politika të qëndrueshme dhe me vizion afatgjat duke mos i ndryshuar ato çdo vit;
- Qeveria duhet të hartojë politika të cilat incentivojnë studentët e mjekësisë ose të shkencave mjekësore teknike që të qendrojnë brenda vendit dhe të japin kontributin e tyre në Shqipëri, duke rritur mbështetjen gjatë kohës që studiojnë në forma të tilla si mbështetja nëpërmjet bursave të studimit, si edhe ofrimin e pagave të kënaqshme pas integritit të tyre në tregun shqiptar të punës.
- IAL-të publike dhe jopublike duhet të informojnë kandidatët të cilët bëhen pjesë e procesit të aplikimit universitar mbi zhvillimin e karrierës në programet e studimit që ato ofrojnë, nëpërmjet platformave online ose duke patur një këshillues karriere në ambientet e IAL-ve gjatë periudhës së aplikimit universitar.
- IAL-të publike duhet të shtojnë buxhetin për fushatat e marketingut gjatë periudhës së regjistrimeve në IAL.

¹¹ Për vitin akademik 2021-2022, duke e krahasuar me vitin akademik 2018-2019.

¹² 2607 kuota të vlefshme, 704 të regjistruar.



#QËNDRESË MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al